



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E SHKENCAVE

Nr. 311/5 prot., datë 25.10.2016

MINISTRIA E FINANCEVE

Nr. 12700/3 prot., datë 11.11.16

UDHËZIM I PËRBASHKËT

“Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave dytësore

që krijon Akademia e Shkencave”

Nr. ____ datë 25.10.16

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 28.6.2006 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore", Ministria e Financave dhe Akademia e Shkencave,

UDHËZOJNË:

A) Në të ardhura nga veprimtari ekonomike dytësore përfshihen të ardhurat që realizojnë institucionet buxhetore nga ofrimi i shërbimeve apo mallrave ndaj të tretëve duke shfrytëzuar kapacitetet e lira të tyre si:

1. Shitja e periodikëve shkencore dhe e botimeve të ndryshme të Akademisë së Shkencave.
2. Shitja e buletineve të ndryshëm shkencore dhe informative të institucioneve të Akademisë së Shkencave
3. Dhënie salle me qera për ore mbledhje.

Tarifat për këto shërbime miratohen nga Ministri i Financave me propozim të Akademisë së Shkencave.

Për pikën 1 dhe 2, këto të ardhura derdhen 70% në Buxhetin e Shtetit. Pjesa prej 30% që i mbetet institucionit do të përdoren për dhënie të çmimeve shkencore kombëtare dhe për konkurset shkencore që do të organizojë Akademia e Shkencave bazuar në ligjin nr.9655 datë 11.12.2006 "Për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë", i ndryshuar", neni 4, pika dh – organizon konkurse dhe dhënie çmime shkencore; në Urdhërin Nr. 11, datë 6 tetor 2016 "Për miratimin e Rregullores për themelimin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave, për mënyrën e organizimit të konkurseve, për kriteret e zgjedhjes së fituesve dhe mënyrën e shpalljes së tyre", si dhe për të kompensuar kostot shtesë që bëhen për këto shërbime dhe mallra.

Për pikën 3, këto të ardhura derdhen 10% në Buxhetin e Shtetit dhe 90% i mbeten institucionit, referuar VKM nr.54 datë 05.02.2014, pika VII, 4, kjo pasi godina gëzon statusin e Monumentit të Kulturës së Kategorisë së I-rë, shpallur me Urdhërin e Ministrit të Kulturës Nr. 67, datë 17.03.2016 "Për shpalljen Monumente Kulture të Kategorisë së I-rë, për objektin Akademia e Shkencave, Tiranë", për tu përdorur për:


- mirëmbajtjen e sallës Aleks Buda, pjesë e godinës së Akademisë së Shkencave.
- mirëmbajtjen e sallës së Librit Akademik.
- si dhe për të kompensuar kostot shtesë që bëhen për këto shërbime dhe mallra.

B) Të ardhurat që mbeten në dispozicion të Institucionit nuk përdoren, në asnjë rast për shpërblime. Ato mund të përdoren vetëm për pagesa për punë të matshme dhe të kontrollueshme sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Udhëzimi hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 01 Janar 2017

AKADEMIA E SHKENCAVE

KRYETARI
MUZAFER KORKUTI



MINISTRIA E FINANCAVE

MINISTRI
ARBEN AHMETAJ

